

## **AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**

### **Deklaratë për mediat e interesuara dhe opinionin publik**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, dëshiron të informojë opinionin publik, pas disa lajmeve në media të ndryshme vizive dhe të shkruara, për kërkesën e kthimit të fondeve nga përfituesit e Programit IPARD nga Agjencia IPARD.

Dëshirojmë t'ju bëjmë me dije se Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, Marrëveshjes Sektoriale, Programit IPARD II të miratuar, si dhe në zbatim të Manualeve të brendshme të funksionimit të saj, u dërgon shkresa njoftuese periodikisht (çdo 6 – 12 muaj) subjekteve përfituese, për t'i rikujtuar zbatimin e detyrimeve kontraktuale që rrjedhin nga kontrata e grantit me AZHBR. Kjo është një procedure standarde e cila i shërben përfituesve të Programit dhe garantimit të funksionalitetit të investimit deri në 5 vite pas pagesës përfundimtare.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, nuk ka nisur shkresa njoftuese për kthimin e fondeve drejt përfituesve të Programit IPARD II, në rast se këto subjekte nuk kanë shkelur dispozitat kontraktuale, apo nuk janë shpallur debitore nga AZHBR.

Ftojme mediat e interesuara që të kërkojnë informacion të plotë dhe shterues pranë AZHBR për çështje të tilla të ndjeshme, të cilat impaktojnë opinionin publik, duke i vënë në dispozicion informacion jo të saktë dhe duke i dizinformuar.

Për çdo kërkesë mbetemi në dispozicionin tuaj duke ju garantuar informacion të plotë dhe transparent.